



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:05.2023

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

KRIJIMIN E KQV-SË SË POSAÇME DHE SASINË E FLETËVE TË VOTIMIT PËR QENDRËN E POSAÇME TË VOTIMIT NR. 4383/01, KZAZ 79, BASHKIA TEPELENË PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 79, bashkia Tepelenë me shkresën nr. 4474 prot., datë 02.05.2023, ‘Kërkohe ngritja e KQV-së së posaçme’, i propozon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit të Posaçme nr.4383/01, Njësia Administrative Qendër, Tepelenë.

Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është administruar Vendimi nr.01 datw 27.04.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër “Kërkesë për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur dhe të dënuar, që ndodhen aktualisht në I EVP Tepelenë, të cilët kanë të drejtë vote po nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve”, të QV 4383/01.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të autorizojë KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë, që të krijojë komisionin e kësaj qendre votimi dhe të marrë masat për të siguruar fletët e votimit të QV nr. 4383/01, nga qendrat e tjera të votimit të KZAZ nr. 79, me procesverbale.

Data: ... 05.2023 Nr:
Ora:



“Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 4383/01, në KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë për zgjedhjet e dates 14 maj 2023”

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 43, nenin 62, pika 2, nenin 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Të autorizoj KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë që me vendim të krijojë dhe emërojë Komisionin e Qendrës së Votimit të Posaçme nr. 4383/01.
2. Të autorizojë KZAZ nr. 79, bashkia Tepelenë të marrë nga 22 fletë votimi për kryetar dhe nga 22 fletë votimi për këshill nga QV nr. 4391/00, QV nr. 4391/01, QV nr. 4392/00, QV nr. 4394/00, QV nr. 4395/00.
3. KZAZ nr. 79 të marrë masat që QV nr. 4383/01, të pajiset me fletët e votimit nga QV-të e cituara në pikën 2.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: .. 05.2023 Nr:
Ora:



“Për krijimin e KQV-së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 4383/01, në KZAZ nr. 79, Bashkia Tepelenë për zgjedhjet e dates 14 maj 2023”